

# MONITORIMI I PROCESIT TË PROKURIMIT NË KOMUNËN E PRISHTINËS REVITALIZIMI I SHKALLËVE DHE NDËRTIMI I MBIKALIMIT NË LAGJEN ARBËRI



U monitorua dosja “**Revitalizimi i shkallëve dhe ndërtimi i mbikalimit në lagjen Arbëria**”, kjo kontratë u nënshkrua nga Komuna e Prishtinës me 23 mars 2018. Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur.

**Autoriteti kontraktues, Komuna e Prishtinës, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit, respektivisht kësaj kontrate kishte bërë këto lëshime:**

- **Komuna e Prishtinës nuk e ka zbatuar Ligjin për Prokurimin Publik** duke mos saktësuar datën e saktë të fillimit dhe të përfundimit të punëve në këtë kontratë;
- **Keq-planifikimi - Komuna e Prishtinës nuk e ka planifikuar projektin siç duhet** dhe si pasojë projekti është dashur të shkurtohet apo të zbatohet i përgjysmuar, kishte mbetur një shumë e konsiderueshme e buxhetit e pa shfrytëzuar dhe është krijuar hapësirë që komuna të jetë palë e paditur për shkak të mos përmbushjes së kontratës.
- **Menaxherët e projektit nuk i kanë përmbushur detyrimet ligjore**, kështu kontrata ishte lidhur që të përfundoj për 120 ditë, ndërsa kishte përfunduar pas gati dy vitesh.
- Në bazë të dokumenteve të ofruara **kontrata në fjalë ka mbetur pa siguri të ekzekutimit të kontratës për më shumë se katër muaj;**
- Plani i menaxhimit të kontratës **nuk kishte qenë i hartuar në bazë të kërkesave ligjore**, madje në një rast i nënshkruar shumë vonë pas emërimit të menaxherit;

## REKOMANDIMET

**1** Autoriteti kontraktues, Komuna e Prishtinës, duhet të saktësoj datën e fillimit dhe përfundimit në secilen kontratë.

**2** Siguria e ekzekutimit të jetë valide gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës në mënyrë të pandërprerë dhe së paku 30 ditë pas përfundimit të kontratës;

**3** Menaxhimi i kontratës të bëhet në mënyrë profesionale dhe të merren masa që kontrata të zbatohet në përpikëri në bazë të kushteve të kontratës;

**4** Komuna të planifikoj projektet me kohë dhe të marr të gjitha masat, duke u siguruar që të mos dalin probleme si rezultat i keq-planifikimit pas nënshkrimit të kontratave;

**5** Komuna duhet të bëjë hulumtim të tregut në mënyrë që të bëhet një parashikim më i përafërt i projekteve.